



REPUBLIKA E KOSOVËS REPUBLIKA KOSOVA REPUBLIC OF KOSOVO
KËSHILLI PAVARUR MBIKËQYRËS PËR SHËRBIMIN CIVIL TË KOSOVËS
NEZAVISNI NADZORNI ODBOR CIVILNE SLUŽBE KOSOVA
INDEPENDENT OVERSIGHT BOARD CIVIL SERVICE OF KOSOVO

Pranuar / Dërguar Priljezen/Prodato Received/Delivered	04.04.2023	3	Viti Year
Organ /Njësia Org./Unit	Pr. Prof. Pr. Prof. Prof. No	Shtesa Protog. Appendix	Sasia Kopjime Quantity
SKIMSHCK	3286/2023		113



Republika e Kosovës
Republika Kosova-Republic of Kosovo

KËSHILLI I PAVARUR MBIKËQYRËS PËR SHËRBIMIN CIVIL TË KOSOVËS
NEZAVISNI NADZORNI ODBOR CIVILNE SLUŽBE KOSOVA
INDEPENDENT OVERSIGHT BOARD FOR THE CIVIL SERVICE OF KOSOVA

A.nr.706/2022

Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës - Kolegji për Shqyrtimin dhe Vendosjen e Ankesave në përbërje nga: Jeton Koca-kryetar, Ardita Haxhnikaj Demi dhe Eshref Shabani- anëtarë, me Ilire Mehmeti-Shaqiri, Zyrtare e Lartë për Bashkëpunim Profesional-në cilësinë e procesmbajtëses, në çështjen administrative sipas ankesës me numër A.nr.148/2021 të datës të datës 17.03.2021, të parashtruar nga ankuesi

kundër organit të punësimit Ministria e Financave, në çështjen juridike "kompensim material", duke vepruar në pajtim me nenin 6 paragrafin 1 nën paragrafin 1.1 dhe nenin 18 paragrafin 1 nën paragrafin 1.8 të Ligjit Nr.06/L-048 për Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës dhe Rregulloren Nr.02/2018 për Procedurën e Shqyrtimit dhe Vendosjes së Ankesave në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, më datën 04.04.2023, mori këtë:

V E N D I M

I. Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil i Kosovës, *Shpallet jo kompetent* për të vendosur për ankesën me numër A.nr.148/2021 të datës 17.03.2021 të parashtruar nga ankuesit

II. Çështja bije në kompetencë të gjykatës se rregullt.

A r s y e t i m

Ankuesit,

që të gjithë të punësuarë në Shtëpinë e Komunitetit të Pleqve në Skenderaj, me datë 17.03.2021 përmes përfaqësuesit të autorizuar, avokatit Shefqet Ibrahimit kanë parashtruar ankesë me numër protokollit 1196/2021 të regjistruar me numër A.nr.148/2021 në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbim Civil të Kosovës, me pretendimin ankimor për



realizimin e kompensimit material sipas Planit Operacional për Pakon Fiskale Emergjente të aprovuar me Vendimin Nr.31/2020 të datës 03.04.2020 të Qeverisë së Republike së Kosovës.

Kolegji i Këshillit, lidhur me juridiksionin e Këshillit në raport ankuesit ju referua dispozitave të Ligjit Nr.06/L-144 për Zyrtarët Publikë, përkatësisht neni 2 ku përcaktohet se: 1. Me këtë ligj rregullohet marrëdhënia juridike ndërmjet shtetit dhe zyrtarëve publikë. 2. Zyrtarë publikë janë: 2.1. nëpunësi i Shërbimit Civil (në tekstin në vijim: nëpunësi civil); 2.2. nëpunësi i Shërbimit Publik; 2.3. nëpunësi i Kabinetit; dhe 2.4. nëpunësi administrativ dhe mbështetës. 3. **Nëpunës civil** - është zyrtari publik në kuadër të Shërbimit Civil, i cili ushtron detyrën në një pozitë, duke filluar nga zyrtari profesional deri në pozitën e sekretarit të përgjithshëm në administratën e Presidentit, në administratën e Kuvendit, në Zyrën e Kryeministrit, në ministri, në agjenci ekzekutive, në agjenci dhe në një degë lokale të tyre, në administratën e institucioneve të sistemit të drejtësisë, në institucion të pavarur, në agjenci të pavarur, në administratën komunale dhe çdo nëpunës i përcaktuar drejtpërdrejt me ligj të veçantë. 4. **Nëpunës i Shërbimit Publik** - është personeli i nivelit të lartë drejtues, drejtues, profesional dhe i shërbimeve të brendshme në administratën e shërbimeve publike, pjesë e administratës shtetërore apo në administratën e shërbimeve publike, pjesë e një komune të cilët ofrojnë shërbime publike të drejtpërdrejta për qytetarët në fushën e arsimit, shëndetësisë, kulturës, artit si dhe shërbime tjera të ngjashme publike. 5. **Nëpunës i Kabinetit** - është zyrtari publik, që ushtron detyrën në Kabinetin e Presidentit, të Kryetarit të Kuvendit, të Kryetarit të Gjykatës Kushtetuese, të Kryeministrit, të Zëvendëskryeministrit, të Ministrit ose të titullarit të një institucioni të pavarur kushtetues dhe të Kryetarit të Komunës. Statusin e nëpunësit të Kabinetit e kanë edhe nëpunësit të cilët ushtrojnë detyrat për nën kryetarin e Kuvendit të Kosovës dhe për grupin parlamentar. 6. **Nëpunës administrativo-teknik - dhe mbështetës** është zyrtari publik, që kryen veprimtari ndihmëse, të mirëmbajtjes, ruajtjes, vozitjes, si dhe veprimtari të tjera të ngjashme në institucionet e administratës publike.

Rrjedhimisht, me Aktgjykimin në rastin nr.KO203/19 të datës 09.07.2020, lidhur me vlerësimin e kushtetutshmërisë së Ligjit Nr.06/L-114 për Zyrtarët Publikë, Gjykata Kushtetuese ka konstatuar se Ligji për Zyrtarët Publikë nuk zbatohet në raport me: Këshillin Gjyqësor të Kosovës; Këshillin Prokurorial të Kosovës; Gjykatën Kushtetuese; Institucionin e Avokatit të Popullit; Auditorin e Përgjithshëm të Kosovës; Komisionin Qendror të Zgjedhjeve; Bankën Qendrore të Kosovës dhe Komisionin e Pavarur të Mediave, përderisa cenohet pavarësia e tyre funksionale dhe organizative e garantuar me Kushtetutë, ndërsa në pikën 211 të aktgjykimit ka specifikuar se: ... Ndërsa, në raport me të gjitha institucionet e tjera, Ligji Nr.06/L-114 për Zyrtarët Publikë zbatohet nga hyrja në fuqi e këtij Aktgjykimi, nga rrjedh se neni 2 (fusha e zbatimit) të Ligji Nr.06/L-114 për Zyrtarët Publikë nuk është shfuqizuar në raport me institucionet e tjera, dhe se e njëjta dispozite është e zbatueshme nga data 09.07.2020.

Duke marr parasysh se nga administrimi i provave të lëndës është konstatuar se të gjithë ankuesit janë të punësuar në Shtëpinë e Komunitetit të Pleqve në Skenderaj, administratë kjo e shërbimeve publike, si pjesë e komunës, që ofron shërbime të drejtpërdrejta për qytetarët (komunitetin e pleqve) në fushën e shëndetësisë dhe duke u bazuar në neni 2 paragrafi 4 ku përcaktohet se: 4. **Nëpunës i Shërbimit Publik** - është personeli i nivelit të lartë drejtues, drejtues, profesional dhe i shërbimeve të brendshme në administratën e shërbimeve publike, pjesë e administratës shtetërore apo në administratën e shërbimeve publike, pjesë e një komune të cilët ofrojnë shërbime publike të drejtpërdrejta për qytetarët në fushën e arsimit, shëndetësisë, kulturës, artit si dhe shërbime tjera të ngjashme publike, konstaton se ankuesit nuk e kanë statusin e nëpunësit civil, Kolegji i Këshillit konstaton se ankuesit e kanë statusin e nëpunësit të shërbimit publikë dhe se Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës nuk është kompetent për shqyrtimin e ankesave të nëpunësve të shërbimit publikë.



Se ankuesit ofroje shërbime shëndetësore dhe e kanë statusin e shërbyesit publikë, rrjedh edhe nga fakti se të njëjtit në ankesën e parashtruar në Këshill pretendojnë realizimin e pagesës shtesë sipas Planit Operacional për Pakon Fiskale Emergjente të aprovuar me Vendimin Nr.31/2020 të datës 03.04.2020 të Qeverisë së Republiksë së Kosovës, gjegjësisht shtesën e përcaktuar me Masën - 6 të këtij dokumenti, e cila masë i referohet stafit mjekësor (mjekët dhe infermieret).

Andaj, duke u bazuar në nenin 6 paragrafi 1 nën paragrafi 1.1 të Ligjit Nr.06/L-048 për Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, ku përcaktohet që Këshilli është kompetent të shqyrtoj dhe të vendos vetëm për ankesat e nëpunësve civil dhe kandidatëve për pranim në shërbimin civil, dhe duke marr parasysh se ankuesit janë të punësuar në kuadër të administratës publike që ofrojnë shërbime shëndetësore të drejtpërdrejta për qytetaret, dhe si rrjedhojë e kanë statusin e nëpunësit të shërbimit publikë, Kolegji i Këshillit konstaton se Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbim Civil të Kosovës nuk është kompetent për të vendosur lidhur me ankesën A.nr.148/2021 të datës 17.03.2021.

Në kuptim të dispozitave të nenit 24 paragrafit 4 të Ligjit Nr.06/L-114 për Zyrtarët Publikë, nëpunësi i shërbimit publik ka të drejtë të ankohet të punëdhënësi dhe më pas mund të fillojë kontest pune në gjykatën kompetente, mirëpo meqenëse nga shkresat e lëndës vërehet se ankuesit kanë shfrytëzuar mjetet juridike pranë organit punëdhënës, Kolegji i Këshillit udhëzon ankuesit për ushtrimin e mjeteve juridike në gjykatë të rregullt në pajtim me dispozitat e Ligjit për Procedurën Kontestimore.

Për sa me sipër dhe duke u bazuar në nenin 18 paragrafin 1 nën paragrafin 1.8 të Ligjit Nr.06/L-048 për Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, Kolegji i Këshillit vendosi si në dispozitiv të këtij Vendimi.

Këshillë juridike: Kundër vendimit të Këshillit, pala e pakënaqur e cila pretendon se vendimi i Këshillit nuk është i ligjshëm mund të iniciojë konflikt administrativ në gjykatën kompetente, Gjykatën Themelore në Prishtinë/Departamenti për Çështje Administrative brenda afatit prej tridhjetë (30) ditësh nga dita në të cilën i është dorëzuar vendimi. Inicimi i konfliktit administrativ nuk e ndalon ekzekutimin e këtij vendimi.

Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës

Lënda A.nr.706/2022

Ilire Mehmeti-Shaqiri

Procesmbajtëse



Kryetar i Kolegjit

Vendimi i dërgohet:

- Përfaqësuesit
- Znj. Liridona Kajtazi - Gjyqtare në Gjykatën Themelore në Prishtinë/ Departamenti për Çështje Administrative;
- Udhëheqësit të Personelit në Komunën e Skenderajt;
- Arkivit të KPMSHCK-së